

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME BESIM MALOTËN

New York | Data: 29 gusht, 2016

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

1. Besim Malota (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anna Di Lellio: *Can you please tell me, we are going to see this, can you please tell me first something about yourself, your name, where you were born, if you don't mind your age. And how you came here, so little bit of your background?* [Ju lutem a kishit mundur të më tregoni, do të shohim, a mund të më tregoni dicka për vetën më së pari, emri juaj, ku keni lindur, nëse nuk ju pengon moshën tuaj. Si erdhët këtu, dicka rreth prapavisë suaj?

Besim Malota: *My name is Besim Malota. I was born in Grabanica, municipality of Klinë in Kosovo. I came in United States in 1986. I left...*[Emri im është Besim Malota. Kam lindur në Grabanicë, komuna e Klinës në Kosovë. Erdha në Shtetet e Bashkuara më 1986. U largova...]

Anna Di Lellio: *Do you want to do it in English or Albanian?* [Dëshironi të flisni në gjuhën angleze apo shqipe?]

Besim Malota: *Albanian is much better for me.* [Shqip do të ishte shumë më mirë për mua.]

Anna Di Lellio: *Yes, I can understand, maybe I will ask you questions in English but yes, just start in Albanian.* [Po, unë kuptoj, ndoshta unë ju bëj pyetjet në anglisht por po, vetëm filloni në shqip.]

Besim Malota: Unë quhem Besim Malota, kam lindur në Grabanicë në komunën e Klinës. Kam ardhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në 1986. Nga Kosova jam larguar më 1983. Kam qenë në Gjermani për disa kohë dhe në Suedi, pastaj kam emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Arsyeja e largimit nga Kosova ka qenë çështja, çështje politike për arsye që kam qenë i persekutuar politik, i arrestuar në Pejë për një kohë pas demonstratave të vitit 1982 të cilat ishin organizuar në Klinë nga një grup i nxënësve të shkollës së mesme Luigj Gurakuqi, me te cilët kam qenë edhe unë bashkërisht. Pushteti i atëhershëm krijonte presion mbi gjithë ne që sa më shumë të largohen nga vendlindja ose të ishin pjesë e atij sistemi i cili nuk ishte pro shqiptarëve.

You have any questions? Me 1986 kur kam ardhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtu kam gjetur shqiptarë të organizuar në klubin kombëtarë, “Jusuf Gërvalla”, të cilëve ju kam bashkuar menjëherë dhe pas gjashtë muajsh është themeluar shoqata “Shpresa” në Bruklin nga një grup të rinjsh nga Kosova, nga viset shqiptare në ish-Jugosllavi në realitet. Pas themelimit të shoqatës “Shpresa”, unë kam qenë sekretar i shoqatës për disa vite dhe kështu që kane filluar aktivitetet e shoqatës “Shpresa” më 1990.

Shoqata “Shpresa” ka ndërmarrë një aktivitet për pajtimin e gjaqeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke ftuar një delegacion nga Kosova, në krye të cilëve ishte edhe profesor Anton Çetta, akademik Mark Krasniqi, Bajram Kelmendi dhe shumë të tjerë. Këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shqiptarët bashkë me ato traditat e veta që i kanë sjellë prej atje e kanë sjellë edhe hakmarrjen. Kemi pasur disa raste me sa me kujtohet mbi dyzetë raste ku kanë qenë në hasmëri familjet shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe shumë prej familjeve ose janë detyruar të largohen prej vendi ku ka ndodhur ngjarja ose të janë gjithmonë të ashtuquajtur besë sipas Kanunit që është praktikuar edhe në vendet tona ajo praktikë, ka vazhduar edhe këtu.

Duke i parë ato rrethanat në të cilën ndodhej populli shqiptarë në Kosovë dhe mënyrën sesi po pajtoheshin shqiptarët në Kosovë, shoqata “Shpresa” vendosi që të merr atë aksion edhe këtu. Shoqata “Shpresa” në atë kohë më caktoi mua si kryesues të atij aksioni dhe një grup shokësh tjerë si Tahir Nikci, Xhevat Kukën, Sami Sylejmanin, Riza Rugovën, Xhavit Kabashin për tu marrë me organizmin e pajtimit të gjaqeve në Shteteve e bashkuara të Amerikës. Brenda shumë pak kohësh arritëm që t’i identifikojmë mbi dyzetë familje shqiptarësh që janë në hasmëri mes vete në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po them në rrethinën e New York-ut shumica kanë qenë në rrethinën e New York-it.

Me ardhjen e siç i quanim ne atëherë Krushqit e Pajtimit, kemi filluar menjëherë që të shkojmë drejt asaj rreth pajtimeve, dhe aksioni i parë është marrë në familjen Gjonbalaj, ka qenë një hasmëri mes familjes Gjonbalaj dhe një familje shkodrane, me duket mbiemrin ja kam harruar por kanë qenë nga Shkodra në hasmëri mes vete. Familja Gjonbalaj jetonte ne New York, ndërsa familja tjetër ishte larguar 6 orë nga New York-u dhe asnjëherë nuk vinte në New York nëse nuk kishin besë nga familja Gjonbalaj. Atëherë ka filluar aksioni me familjen Gjonbalaj edhe pse hasëm në vështirësi shumë të mëdha, dhe na mori më shumë sesa 6 orë, aty patëm një sukses sepse vëllezërit Adriatik Gjonbalaj, në të vërtet djali Adriatik Gjonbalaj i viktimës e fali gjakun e babës, dhe ajo u përhap menjëherë përmes radiostacionit që ne e kishim në atë kohë Zërin e Kosovës në New York. Pastaj u komunikuar edhe në kishë, në xhami dhe në çdo vend tjetër dhe kështu që vazhduan me ra pajtimet.

Pas aty kemi vazhduar me familjen Shabani dhe shumë e shumë familje tjera që ishin në hasmëri ne mes vete. Grupi që udhëhiqte me pajtimin e gjaqeve ndërmori shumë aksione gjatë atyre ditëve duke i pajtuar jo vetëm gjaqet por edhe hasmëritë më të vogla që kanë qenë, rrahjet apo disa çështje të ndryshme që kanë qenë edhe numri i tyre shkoi deri ne rreth 80 pajtime në New York. Pastaj grupi është ndarë edhe në pjesën tjetër te cilët kanë shkuar në Detroit, edhe atje ka pasë disa pajtime, por jo ashtu sic kanë menduar shumica se në Detroit ka hakmarrje, e në realitet nuk ishte e vërtet, se në Detroit nuk kishte aq shumë sa kishte në New York.

Në Detroit janë pajtuar me duket se vetëm 6 familje kurse tjerat i qëndronin asaj Besëlidhjes së Malësisë mbrapa dhe në atë drejtim profesor Anton Çetta nuk ka pasur dëshirë që ti shtyj më tutje, të shkojnë më larg se ajo besa që e kanë pasë lidhur në 1974 nëse nuk gabohem në Mal të Zi shqiptarët e malësisë së madhe. Kjo ka qenë pjesë e atij aktiviteti që është mbajtur në atë kohë, atij aktiviteti i janë bashkuar edhe shumë njerëz të tjerë të komunitetit shqiptarë. Pastaj ka qenë përkrahja e Ligës Qytetare Shqiptare Amerikane në krye me Xhozep Jogardin e shumë e shumë bashkatdhetar që ishin këtu, të cilët kishin informacione mbi familjet të cilat ishin në hasmëri, vinin na tregonin pastaj

përgatitnin shkuarjen e grupit të pajtimit të gjaqeve të cilët ishin të ndarë në dy grupe, njërin e udhëhiqte Anton Çetta dhe tjetri nga akademik Mark Krasniqi.

Grupi ka qenë mjaft i madh sepse nga Kosova erdhën 16 vetë duke përfshirë Zikri Hasanin, Bajram Kelmendin, Nekibe Kelmendin, profesorë doktor Agim Vincën, Mustafë Radoniqin, avokatin Adem Bajra, doktor Mustafë Logja dhe një numër tjetër që ishin bashkë me ta aty nuk më kujtohen, Mulla Xhevati i cili ishte poashtu në krye të këtij delegacioni bashkë me Anton Çettën dhe akademik Mark Krasniqin. I vetmi i cili nuk mund të vinte në atë kohë ishte doktor Don Lush Gjergji për shkak se kishte takim në Vatikan edhe pse ishte i ftuar, e kishim marrë konfirmimin e tina, ai u detyrua që të shkojë në Vatikan bashkë me Ibrahim Rugovën dhe e anuloi atë vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. *If you ask me more questions probably things come in my mind you know?*

Anna Di Lellio: Sa e vështirë është puna e delegacionit?

Besim Malota: Ka qenë mjaft e vështirë për shkak se shoqata “Shpresa” në atë kohë ishte e përbërë prej një grupi studentësh. Të gjithë ishin pothuajse punëtorë që jetonin me një rrogë dhe se anëtarësia e shoqatës nuk kishte ndonjë mundësi aq të madhe të veprimit, por megjithatë të gjithë kanë sakrifikuar duke shtuar anëtarësi, duke dhënë më shumë kontribut në shoqatë që të arritët kjo, që të pajtohen gjaqet edhe këtu në Shtete të Bashkuara të Amerikës.

Jemi mjaft krenar për ato që kanë ndodhur sepse që nga atëherë e deri më sot nuk kemi më as vrasje e as gjakmarrje. Do të thotë, pothuajse i ka shuar të gjitha përnjëherë ai rast që ka ndodhur në New York.

Vështirësitë kanë qenë edhe tek njerëzit që u shkonim në shtëpi, sepse ata që kishin viktimë, do të thotë familjarët e viktimës nuk e kuptonin se nuk po kërkohet falje në emër të atij që e ka kryer krimin, por po kërkohet falje në emër të popullit dhe jo në emër të atij që e ka kryer krimin. Ka qenë shumë e vështirë, sidomos fillimi me familjen Gjonbalaj sic e thashë edhe më parë ka ndodhur mbi gjashtë orë, që i tërë delegacioni prej 16 vetëve plus pastaj nga komuniteti që ishte aty mbi 50 vetë dhe nuk arrinin që ta bindnim familjen Gjonbalaj që të shtrinë dorën e pajtimit.

Më në fund Anton Çetta ka kërkuar që të takoj nënën e viktimës, do të thotë viktimë është quajtur Dinqa Feta, sipas mbiemrit Dingjonbalaj. Anton Çetta e takon nënën e tij, ajo ishte e sëmurë, në krevat para vdekje, dhe ka biseduar me të për 30 minuta, edhe me në fund i kërkon asaj që të shtrij dorën e pajtimit për djalin e saj që të mos lej më ngatërresa në familje, që të mos vazhdohet më ajo lloj tradite. Dhe nëna e tij në realitet edhe pse 92 vjeçare e fal gjakun e të birit dhe kërkon nga nipat, djemtë e djalit edhe nga djali i saj i cili ishte aty, vëllai i viktimës, që edhe ata të vepronin sipas saj edhe ajo edhe nuk kishte as mundësi që të ngrihet nga krevati që të vij të ua jep dorën të tjerëve sepse ishte në një gjendje shumë të rëndë dhe ishte shumë e vjetër. Dhe kështu që arritëm të pajtojmë gjakun e parë, pastaj nga aty kemi pasur raste mjaft tjera që kanë qenë shumë problematike vrasjet.

Ne nuk kërkonim të na tregonin se pse janë vrasë, nuk na interesonte se pse janë vrasë, çka i ka shtyrë deri te vrasja, kush është fajtori, nuk kërkonim në asnjë mënyrë fajtorin sepse nuk kishim shkuar ta gjykonim vrasjen, ato i takojnë drejtësisë. Ne kërkonim që të faleshin, që njëherë e përgjithmonë ti jepet fund hakmarrjes. Kanë qenë mjaft të vështira sidomos edhe në Detroit, rasti i Detroitit ka qenë edhe më i vështirë sepse ka qenë babë dhe djalë që po faleshin. Edhe atje, unë nuk kam qenë në Detroit ka qenë Tahir Nikçi veprimtar i shoqatës “Shpresa” i cili ka udhëhequr grupin në Detroit, por siç na tregonte ai nga ajo familje që ka arrit atje pajtimin.

Vëllai i viktimës nuk pranon, në realitet ka qenë vëllai dhe djali ka pasë me i falë. Vëllai i viktimës nuk pranon të falë në asnjë mënyrë, edhe pse u kishte bërë një pritje madhështore, i ngrinte aq lartë delegacionin, u thoshte se “ Ju jeni koka e kombit, ju jeni njerëzit më të mëdhenj”, edhe pse ishte presioni shumë i madh i Don Anton Kqirës, priftit të kishës katolike në Detroit i cili kërkonte me çdo kusht që të falet gjaku. Ai më në fund i thotë, “Këtu nuk mundet të behet asgjë”. Dhe nëna e tij pas disa orësh ngritët në këmbë dhe i thotë të birit, “Po, ti mor birë gjithë këta burra, gjithë këta burra i ngrite aq lart, i çove aq lart, e në fund u thua jo.” Thotë, “Burrnia nuk e ka kështu, unë jam grua por besa zotit për djalë tim flas vetë”, dhe i afrohet Anton Cettes dhe ia zgjat dorën dhe i thotë, “Qoftë fal gjaku i djalit”. Por nuk e përmend nipin sepse nipi ishte djali i djalit të saj, dhe i thotë, “Tash është radha jote, unë e fala djalin tim, ti duhesh me fal djalin tënd”. Edhe aty arritët edhe ai pajtim.

Kemi pasur raste mjaft delikate këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, raste të cilat kanë ndodhur këtu dhe nuk janë, nuk kanë qenë të importuara, por kanë ndodhur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vrasjet. Por megjithatë është përmbyllur me një sukses shumë të madh, dhe shpresoj që të mos kemi më nevoja të tilla. Unë jam kundër faljes së gjaqeve tash, jam kundër asaj që të shkohet t’u kërkohet njerëzve, “Fale gjakun”. Njerëzit duhen të vetëdijesohen se tashmë nuk është më koha e Kanunit, është koha e ligjit dhe shteti duhet të funksionojë dhe çdo gjë duhet t’i lihet ligjit.

Viktima duhet dënuar sipas ligjit dhe nuk duhet që njerëzit të ngujohen, familjet të mbyllen. Shpresoj që shumë shpejt kjo ka me u kuptuar edhe te ne në Kosovë, e sidomos në Shqipëri sepse atje tash është problemi shumë më i madh sesa në Kosovë. Njerëzit ta dinë që koha e Kanunit është e kaluar, Kanuni ka vepruar gjatë perandorisë Otomane. Edhe pse Kanuni nëse shpjegohet në mënyrë më të drejtë ka qenë një dypushtet gjatë perandorisë Osmane sepse shqiptarët asnjëherë nuk e kanë njohur perandorinë Osmane, tregon vetë Kanuni, sepse vetë shqiptarët i kanë zgjedhur problemet sipas dokeve dhe zakoneve të tyre dhe jo sipas ligjeve të Turqisë. Kjo është një formë e dypushtetit ose një pushteti paralel që për 560 vite shqiptarët e kanë mbajtur kundër Turqisë.

Tash ajo është veç e tejkaluar dhe njerëzit duhen me ditë se kur janë ligjet të cilat duhen të funksionojnë dhe jo më Kanuni, me gjithë respektin për një vepër të madhe si Kanuni është. Unë e kam lexuar disa herë dhe është ligjet ma liberale të asaj kohe. Nëse i krahasojmë ligjet e Kanunit, për shembull me ligjet Anglisë apo vendeve tjera, Kanuni është shumë ma liberal sesa ligjet e mbretërive tjera që kanë qenë nëpër vendet e Evropës. Po edhe ai është tejkaluar dhe duhet populli sa më pak, ta kuptoj që tani është i tejkaluar dhe nuk duhet me përdorë as me u bazuar në kanun.

Anna Di Lellio: A i kujtoni rastet tjera te pajtimeve në New York ose në Detroit?

Besim Malota: Në Detroit unë nuk kam qenë, ka qenë pjesë e Tahir Nikçit, një koleg tjetër i cili është këtu në New York edhe ai jeton. Ai i dinë më mirë rastet e Detroitit, ndërsa këtu kemi pasur disa prej rasteve. Për shembull, më kujtohet rasti i familjes së Mark Shabani dhe familja Domgjoni, dy familje të cilat janë nga komuna e Gjakovës, por jetojnë dy palët këtu njëherë. Ata kanë qenë miq mes vete. Ka ndodhur një vrasje në familje aty, familja Domgjoni në realitet e ka dëmtuar familjen Shabani. Ka qenë këtu njëfarë profesor Marian Shabani më herët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i cili është vrarë nga familja Domgjoni. Ai megjithëse ka qenë edhe dhëndër i asaj familje, por ato kanë qenë problemet ndërmjet familjes mes vete dhe ka shkuar deri në vrasje.

Gjergj Domgjoni ka qenë edhe anëtar i shoqatës “Shpresa”, edhe pikërisht ky rast është ai i cili shoqata “Shpresa” është angazhuar në këtë drejtim më shumë për shkak se njëri prej anëtarëve të këshillit të shoqatës “Shpresa” ishte pikërisht në hasmëri me familjen Shabani. Edhe çdo kohë u dashke që ai njëri të merr besë nga familja Shabani që të jetë i lirë në New York, e nëse ai nuk kishte besë, ai do të thotë nuk mund të dilte, nuk mund të shkonte askund, ishte i izoluar tërësisht. Ai normal që shkonte në punë, kthehej nga puna por nuk dilte në takime edhe kjo pikërisht ka qenë arsyeja pse shoqata “Shpresa” e zgjodhi këtë aktivitet, sepse kishim njërin prej anëtarëve tonë që ishte në hasmëri, edhe pse ai nuk ishte personi që kishte kryer krimin, por ishte pjesë e asaj familje.

Kemi pasur këtë rastin e familjes Shabani, kemi shkuar te familja Shabani, kam biseduar vetë personalisht me Mark Shabanin, vëllain e viktimës Marian Shabanin, i kam kërkuar që të zgjat dorën e pajtimit, edhe pse që nuk kam arrit që ta bind prej telefonit, prej bisedave. Më në fund i kam kërkuar, i kam thënë, “Marian zakoni shqiptarë është që dera hapet për çdokënd, ne jemi duke ardhur nesër, ne do të jemi në kishë në ora 12, pas kishë do të jemi në shtëpinë tënde, prandaj duhet ta dish që të na pritësh në shtëpi. E fal apo nuk e fal, arrimë marrëveshje apo nuk arrimë marrëveshje, zakoni është që ti të na pritësh në shtëpi, pastaj ti vendos ato, ne i kemi fjalët tona ti i ke tuat”. Pastaj kemi shkuar, e kemi takuar, profesor Anton Çetta na tregoi që ka qenë disa herë edhe te i vëllai i tij në Kosovë dhe nuk ka gjetur mirëkuptim, nuk ka arritur që ta pajtoj familjen në Kosovë.

Kemi biseduar me Mark Shabanin edhe ai e ka zgjatur por ka kërkuar një javë kohë që ai të merret edhe me pjesën tjetër të familjes në Kosovë. Edhe pas një jave, në realitet pasë tri apo katër ditësh më ka marrë në telefon dhe më thotë, “Ju pres të shtunën te shtëpia”. Atëherë e kam kuptuar që kjo është punë e kryer edhe e kam njoftuar Anton Çettën dhe grupin që ishin, që do të shkojmë te Mark Shabani sepse është arrit marrëveshja mes vëllezërve dhe ai do ta jep fjalën e fundit. Kemi pasë edhe raste tjera këtu, disa Vuthjanë që kanë qenë në hasmëri, nuk na kanë pritur mirë, kanë qenë vështirë kur ke shkuar tek familjet sepse nuk të pritnin me atë bujarinë, me të thënë, “Hajde, mire se erdhe,” por si me zor detyroheshim të hynim në shtëpi. Kemi pasur raste edhe kur na kanë sulmuar te dera, kemi pasur një rast shumë të keq, na ka sulmuar te dera e shtëpisë.

Anna Di Lellio: Po, a mund të na e tregoni?

Besim Malota: Njëri prej vëllezërve, familja Ahmetaj, njëri prej vëllezërve ishte i moshës së re, diku nëse nuk gaboj ka qenë 20 vjeçar. Kurse vëllai tjetër ishte në dhomë lart, edhe kur ne i shkuam te dera, nuk ka qenë i pa njoftuar, ka qenë i njoftuar që do të shkojmë, mirëpo me të gjithë një prej delegacioni ishte aty Mark Krasniqi. Edhe pasi i bie ziles, ai e hap derën edhe kur e hap derën, jo që nuk i thotë, “Hajde, urdhëro!”, por me një bejsboll shkop i mësyn. Ndjesë pastë Bajram Kelmendi ka qëlluar i dyti edhe ai e ngreh profesorin mbrapa edhe i del edhe ia kap atë, sepse Bajrami ishte mjaft i fuqishëm edhe ja kap atë bejsboll shkop, dhe pastaj ne pak u tronditem dhe kaluam ne tjerët. Doli vëllai i tij dhe ai e pa se çfarë ndodhi, u krijua një tollovi aty para derës, ai i ra të vëllait shuplakë, u turpërua deri në fund, kërkoi që të hymë brenda, mirëpo pak u krijua njëfarë paniku dhe ne vendosëm që të mos hymë brenda për shkak që të merren ata mes vete si familje dhe do shkojmë radhën tjetër. Në realitet nuk kemi shkuar më, por në mbrëmje kanë ardhur krejt familja dhe ishim të vendosur në New Jersey, në hotel dhe aty ka qenë një restorant shqiptar “Il Galletto ” dhe kanë ardhur ata në mbrëmje në Hotel Il Galletto dhe na kanë takuar dhe e kanë falë gjakun. Kemi pasur lloj rastesh.

Një rast tjetër është thirrë policia në Greenwich Connecticut, është thirrë policia dhe është kërkuar arrestimi i Anton Çettës, çka në realitet policia ka vepruar në atë formë sepse nuk e ka ditur se çfarë është problemi edhe personat. Që unë kam qenë aty, personi që ka qenë aty u tregon policisë arsyen se pse kanë shkuar, dhe ata thonë, “Si?” Thotë, “Po, për shkak të këtij njeri që jeton në Greenwich është një familje në Kosovë e cila është e mbyllur dhe nuk guxon të dali jashtë, nuk guxon t’i çon fëmijët në shkollë, nuk guxon të bëj asgjë”. Dhe ata thonë, “Çka është kjo?” Dhe i kërkojnë atij i cili kishte kërkuar që të arrestonin Anton Çettën, thonë, “Pse na ke thirrur këta qenkan të paqes, jo asaj që ti ke thënë që këta kanë ardhur me të kërcënuar.” Personi që i ka shoqëruar thotë, “Jo, more, ky nuk ka ardhur me kërcënuar, se ky është një profesor i Univerzitetit, kurse tjetri është avokat shumë i njohur në Kosovë”. Ka qenë Bajram Kelmendi me të, thotë, “Nuk kanë ardhur me kërcënuar, por kanë ardhur për këtë arsye”. Edhe largohen prej aty dhe me atë njeri nuk kemi pasur ndonjë marrëveshje. Ai është nga familja Lekaj, të komunës së Deqanit aty edhe ka filluar pajtimi i gjaqeve, aty ka qenë hasmëria si Have Shala me grupin e saj e kanë filluar.

Ai gjak është i pa falur edhe sot, sepse personi i cili nuk ka pranuar asnjëherë. Ai jeton këtu në Greenwich këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe ishte personi i cili donte të arrestonte edhe Anton Çettën, se le më të fal gjakun. Kemi pasur raste të llojllojshme, pastaj kemi pasur rrahje, fjalosjesh mes njerëzve të cilëve i kemi pajtuar, nuk kemi hasur ndonjë vështirësi, vështirësi kemi hasur vetëm të gjaqet më së shumti. Kemi pasur gjaqe edhe të besimeve të ndryshme, jo ka qenë i besimit katolik ai që e ka vrarë, jo ka qenë i besimit mysliman ky që e ka vrarë atë të besimit katolikë, ato kanë qenë pak më problematike sepse njerëzit i nxisnin edhe më shumë por i kemi pajtuar edhe ato, kemi arritur që ti pajtojmë edhe ato, kurse atje në Detroit, atje ekziston një lloj tjetër i pajtimit sepse në 1974 nëse nuk gabohem është në Deqiq afër Tuzit është Deqiqi aty, nuk jam i sigurtë në Deqiq apo Traboinë, më duket se në Traboinë është lidhë besa. Profesorë Gergj Gjokaj ka qenë nga Tuzi i cili ka organizuar një lloj bese sepse në atë kohë tek shqiptarët në Mal të Zi.

Ana di Lellio: Me ‘40, 1940?

Besim Malota: Në vitin 1974.

Ana di Lellio: 1974 okay.

Besim Malota: Është Besëlidhja e Malësisë quhet dhe ai e ka organizuar një sistem krejtësisht tjetër sepse ai i ka njohur shqiptarët në Mal të Zi sesa është vështirë t’i kërkosh dikujt të fal gjakun. Ai i ka arritur t’i bind, mos e fal gjakun, por ama pjesa tjetër e familjes duhet me qenë e lirë. Duhet me qenë i lirë i biri, shoqja, vëllai dhe çdo njeri tjetër në familje përpos ai i cili e ka kryer veprimin, atë mos e fal, por me tjerët mos u merrë. Dhe ai ka arritur që ta lidhë atë besë edhe kur e ka organizuar atë lloj ceremonie, atëherë në ato vite çdo familje e ka pasur përfaqësuesin e familjes të cilët kanë lidhur besë, që nga sot e tutje në Malësi nuk ka gjakmarrje përpos dorasin, përpos ai që ka kryer aktin, nëse mundesh me vra atë, ka marrë gjak. Nëse ka vrarë të birin e tij nuk je në Besë të Malësisë edhe më nuk ke marrë gjak por ke ra në gjak, nëse ke vrarë të birin ose të vëllain apo kushëririn.

Ai e ka arritur atë lloj sistemi atje i cili ka qenë mjaft i suksesshëm, sepse unë e kam njohur personalisht profesorë Gergj Gjokën edhe e kam pyetur, “Pse nuk ke kërkuar që të mos bëhen më hakmarrjet?” Edhe thotë, “Është e pamundur, por unë të garantoj një gjë, se hakmarrja nuk do të ndodhë kurrë, sepse viktimi, në realitet kriminelin i cili ka kryer krimin po shkon në burg 15 vite, kur del

prej burgu ai i del i rraskapitur, edhe sa vite mund të jetoi ai, dhjetë, asnjë nuk i ka bërë dhjetë apo 15,” thotë, “të gjithë kanë vdekur,” thotë, “edhe me të shuhet, nuk ka më, ai vdiq, nuk ke mundur me vra, ka vdekur është shuar, nuk ke gjak”.

Ata i qëndrojnë asaj besëlidhje edhe sot, pjesa e shqiptarëve që janë në Mal të Zi, që janë në rrethinën e Tuzit, e të njëjtin sistem e kanë edhe këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Detroit apo New York, kudo që janë. Ne i quajmë malësorë, kudo që janë ata, nëse ndodhë një vrasje, ka ndodhë sidomos në Detroit kanë ndodhur disa vrasje para se ti shkon askush për ngushëllime të shtëpia ose i shkon prifti i kishës ose i shkon një kryeplak i një familje edhe e pyet të zotit e shtëpisë, “A je në Besë të Malësisë?” Nëse ai thotë jo, asnjë malësor nuk i shkon as në funeral, dhe as nuk i shkon për krye shëndosh, do të thotë e injorojnë tërësisht. Dhe atë asnjëri prej tyre nuk e bën, çdonjëri prej tyre thotë që, “Po, jam në Besë të Malësisë”, edhe kështu që në momentin që ai thotë, “Jam në Besë të Malësisë”, të paret njerëz që shkojnë për ngushëllime në familje janë ata që kanë kryer krimin, familja e atij që e ka krye krimin, ata shkojnë dhe janë të lirë. I shkojnë në funeral, i shkojnë në shtëpi, i shkojnë çdo kund, takohen mes vete, çdo gjë është në rregull. Kjo është një formë tjetër, që për mendimin timin kjo është dashur të praktikohet në Shqipëri, sepse sot në Shqipëri është problemi më i madh i gjakmarrjes, është dashur të praktikohet por nuk po praktikohet askund.

Anna Di Lellio: Por jo në Kosovë, jo në Kosovë tash.

Besim Malota: Në Kosovë ka disa vrasje që kanë ndodhur më vonë, mirëpo atje intervenohet më shumë për shkak se akoma është grupi që janë, që kanë qenë me Anton Qetën si Mulla Xhevati. Mu më ka ra rast vet të marrë pjesë në pajtim në Kosovë pas lufte, me Mulla Xhevatit dhe disa tjerë, isha atje në pushim dhe Mulla Xhevati erdhi dhe më morri dhe shkuam në pajtim atje në Kosovë dhe u pajtua ajo familje në Kosovë. Deri sa ky grup të jetë është pak ma lehtë sepse janë njerëzit të cilët kanë pajtuar shumë gjaqe edhe njerëz që kanë një respekt ndaj tyre, edhe prapë do të thotë e pranojnë kërkesën e tyre që të falin gjakun apo diçka tjetër, kurse në Shqipëri është shumë problematike, shumë problematike çështja e hakmarrjes.

Anna Di Lellio: Po, e di, e di.

Besim Malota: Pastaj interpretimi i Kanunit, çdo lagje e interpreton Kanunin si donë ai. Do të thotë, Kanuni vlen si them unë, as që merren me të se çka është Kanuni, apo çka është e drejta zakonore, cila është e grumbulluar nga Shtjefën Gjeçovi, as që merren me ato. Edhe ato grupet, edhe ato misionet kam pasur kontakte disa herë me ta në Shqipëri që janë për pajtimin e gjaqeve. Edhe ata vetë nuk janë të interesuar, më shumë janë të interesuar me përfituar, nga ato hasmëritë sesa t’i pajtojnë. Se ata kur i shkojnë dikujt në shtëpi, i shkojnë në emër të Kanunit, një gjë që është absurde, absurditet t’i shkosh dikujt t’i thuash në emër të Kanunit kam ardhur. Ti duhet të shkosh dhe të ia shpjegosh se sot është kohë tjetër, janë ligjet e shtetit ato që do të merren, personi që e ka bërë krimin është dënuar, edhe tjerët duhen me qenë të lirë, tjetër nuk janë fajtor, nuk janë bashkëfajtorë ata, ata duhen me qenë të lirë. Jo, ata shkojnë në emër të Kanunit, edhe kështu që i mbajnë lidhur dhe mbyllur njerëzit edhe sot.

Anna Di Lellio: Po.

Besim Malota: Unë jam plotësisht kundër atyre formave që t’i shkosh në emër të Kanunit t’i kërkosh falje. Duhet të shkosh dhe t’i shpjegosh. Unë e thashë edhe më parë, edhe Anton Çetta edhe çdonjëri

prej tyre nuk kanë kërkuar falje në emër të Kanunit, as që janë marrë me atë të drejtë të zakonore, se po të hysh me atë të drejtë zakonore ti i ke borxh dhe ai nuk të fal.

Anna Di Lellio: A i kujtoni fjalët e Anton Çettës ose Kelmendit?

Besim Malota: Në çdo rast që Anton Çetta, ka qenë një delegacion shumë i gjerë dhe të gjithë kanë folur, në çdo rast që Anton Çetta, se në pjesën kryesore që ishim me të e fillonte Anton Çetta, ishim të ndarë në dy grupe, njëri ishte akademik Mark Krasniqi që e udhëhiqte, dhe njërin ishte Anton Çetta. Në çdo rast që e ka filluar, e ka filluar në emër të rinisë, duke i kërkuar falje dhe i ka shpjeguar arsyen pse duhet të bëhet kjo, pse njerëzit duhet t'i ikin kësaj rruge dhe ai gjithmonë i ka thënë që nuk duhet bazuar shumë në Kanun. Kanuni nuk është ai që të thotë duhesh me mbyll një familje, ato kanë qenë ligje të asaj kohë jo të tashmës. Edhe çdo herë ju ka treguar që sot është momenti që ne jemi në hasmëri me të tjerët e nuk kemi nevojë me qenë në hasmëri me njëri tjetrin.

Në Kosovë ka pasur me mijëra gjaqe, me mijëra pajtime që kanë ndodhur në Kosovë, çka do të thotë, janë sipas një libri që kam lexuar janë diku deri te 1200-1300 pajtime. E nëse janë 1200-1300 pajtime po flasim për 1200-1300 familje, ne po flasim për 200.000–300.000 njerëz të ngujuar në burgje të panevojshme. Edhe ai gjithmonë e ka shpjeguar që kjo është vullneti i rinisë, “Nuk kemi ardhur në emër të atij që e ka bërë krimin, nuk kemi ardhur me të thënë, ‘Fali ata,’ por ‘Falna neve, falja rinisë së Kosovës, falja popullit të Kosovës.’”

Edhe këtu kanë qenë momentet ma kryesore të tij që ai arrinte çdo vend t'i binde njerëz sepse nuk shkante në emër të atij që kishte kryer krimin, se po të shkosh në emër të tij. Pastaj fillon ajo, “Jo, ma ka bërë kështu, ja ma ka bërë kështu, jo më tha kështu, ja ndodhi për këtë.” Ai as që dëshironte mi dëgjuar ato, si fillonin ato rrethanat mu fol, ai thoshte, “Jo, nuk dua të di, nuk kam ardhur këtu si gjyqtarë me caktuar se cili është fajtor, as që më intereson ta di pse ka ndodhur, kam pajtuar me qindra e qindra gjaqe dhe askund s’kam pyetur”.

Anna Di Lellio: Në Amerikë ose në Kosovë?

Besim Malota: Jo, në Amerikë.

Anna Di Lellio: Në Amerikë. Sa gjatë ishte fushata?

Besim Malota: Ka qenë 30 ditë. Ata ishin këtu për 30 ditë, ishin të vendosur në hotel sepse ishin delegacion shumë i gjerë. Pasi çdo ditë kishim lëvizje prej një vendi një vend tjetri, domethënë nuk ishte shumë e lehtë, sepse është dashur të shkojmë në Kenrtrigde atje për ndonjë pajtim, Waterbury neper New Jersey, New York. Grupi tjetër udhëtoi për Detroit atje, edhe ata atje, shqiptarët në Detroit, Michigan.

Ana di Lellio: Sa ju ka kushtuar?

Besim Malota: Ka kushtuar mjaftë, diku deri 130,000 dollarë në atë kohë ka kushtuar i tërë aksioni, për shkak që kanë qenë shpenzimet shumë të mëdha.

Anna Di Lellio: Ishte financuar nga kush?

Besim Malota: Shoqata Shpresa e ka financuar, pjesa më e madhe ka qenë nga shoqata Shpresa. Pastaj është shtruar një darkë lamtumire për delegacionin e pajtimeve të gjaqeve edhe aty ka qenë një

numër shumë i madh më duket 500 apo 600 vetë. Të ardhurat e asaj darke kanë qenë edhe ato për shpenzime që janë luajtur. Në atë kohë përpos vëllezërve Bytyqi, tjerët vetëm fjalë mund të kanë pasur sepse nuk kanë kontribuar, kurse vëllezërit Bytyqi po. Sergio Bytyqi ka kontribuar bashkë me vëllezërit e tij, sepse ai ka shtruar një drekë në Manhattan në restorantin e tij, në “Toscana”.

Anna Di Lellio: Shaqir Gashi, jo?

Besim Malota: Shaqir Gashi ka shtruar një drekë në fillim, por dreka kemi pasur nga çdokush. Njerëzit i kanë thirrur në çdo vend, ai për drekë, ky për darkë ato po. Por kur vjen te kontributi material për shembull vëllezërit Bytyqi jo që kanë shtruar dreken por i kanë ftuar mysafiret edhe çdonjëri prej mysafireve ka paguar 150 dollarë dreken. Ata 150 dollarë nuk i kanë ndal për shpenzime të restorantit por na i kanë dhënë shoqatës, si kontribut nga vëllezërit Bytyqi për të na ndihmuar në atë fushatën e pajtimeve. Nuk jam i sigurt sa kanë qenë, por e di që kanë qenë diku rreth një qind e disa persona që kanë qenë, dhe ai ka qenë i vetmi kontribut që kemi marrë nga shqiptarët këtu në Amerikë.

Liga Qytetare Shqiptare ka premtuar, por në fund është tërhequr dhe nuk ka kontribuar me asnjë peni. Bile kemi pasur edhe mosmarrëveshje me ta për arsye se edhe kanë marrë pjesë në darkë edhe kërkonin që të merrnin edhe të ardhurat e darkës. Ne i thamë, “Po ju a jeni në vete?” Kontributi ka qenë më shumë i të rinjve të cilët kanë qenë anëtarë të shoqatës “Shpresa”. Unë i vlerësoj ata, sepse vetëm anëtarët e shoqatës “Shpresa” i kanë mbuluar shpenzimet. Pasi është kryer krejt, çkado që kemi pasur, do të thotë, nga ai grumbullim i asaj darke nga vëllezërit Bytyqi, nuk mund ti anashkaloj edhe vëllezërit Brumqaj sepse ata kanë pasur një kosto më të lartë, në restorantin e tyre ka qenë mëngjesi edhe darka çdo ditë. Por ka qenë marrëveshje e pagesës, se jo falas, po më në fund Ali Brumqaj edhe ai 5000 dollarë i ka heq nga pagesa sepse atë e di vetë sepse vetë e kam nënshkruar çdo ditë, edhe kur e kam bërë bilancin me të, i ka hequr 5000 dollarë nga pagesa, tjerat ia kemi paguar të gjitha.

Anna Di Lellio: Sa vjeç ishit?

Besim Malota: Unë kam qenë në moshën 23 vjeçare në atë kohë, pothuajse më i riu në delegacion kam qenë. Në atë kohë nuk kam qenë as në kryesinë e shoqatës, por kryesia e shoqatës kur e ka marrë aksionin i ka përcaktuar njerëzit se kush do të merret me këtë grup, ndërsa unë kam qenë udhëheqës i grupit. Kjo nuk është meritë e imja, ka qenë meritë e shoqatës, meritë e të gjithëve. Kanë qenë Jakup Krasniqi kryetar, Sami Sylejmani i cili ka qenë sekretar i shoqatës, pastaj ka qenë kryesia e shoqatës që kanë marrë pjesë, kurse të caktuar me grupin kemi qenë unë, Xhevat Kukaj i cili ishte edhe kryeredaktor i radios, se ne kishim edhe në atë kohë emisionin tonë Radio “Zërin e Kosovës” në New York. Tahir Nikçi, Riza Rugova e shumë e shumë të tjerë që kanë qenë pjesë e asaj. Për mua ishte vetëm rasti që mua mu dha.

Anna Di Lellio: Kur e keni filluar “Shpresën”?

Besim Malota: “Shpresa” ka filluar në 1986.

Anna Di Lellio: 1986.

Besim Malota: Unë kam ardhur në 1986 këtu në Amerikë. Kur kam ardhur këtu në Amerikë ka qenë vetëm klubi kombëtar “Jusuf Gervalla”. Kanë qenë edhe këto partitë tjera, jo Balli Kombëtarë, jo Lidhja e Dytë e Prizrenit, Lëvizja Ilegaliteti pastaj edhe disa parti tjera që kanë qenë independent. Por ka pasë shumë hasmëri mes këtyre grupeve, ishte një hasmëri shumë e madhe, në vend që të luftonin

Beogradin këta merreshin mes vete këtu. Jo, kush është majtist? Jo, kush është komunistë? Unë kur jam ardhur jam angazhuar në klubin kombëtar “Jusuf Gervalla”, sepse aty i kam gjetur shumicën dhe është e vërteta se klubi kombëtar “Jusuf Gervalla” ishte nën ndikimin e Shqipërisë.

Anna Di Lellio: Pse?

Besim Malota: Ishte nën ndikim e misionit permanent që ishte në Kombet e Bashkuara dhe ata nuk bënin asnjë veprim tjetër pos atyre veprimeve që drejtoheshin nga misioni i Shqipërisë, në mënyrën sesi të organizohen dhe çfarë të bënin. Nuk kam qëndruar shumë, kam parë pakënaqësi shumë të madhe tek njerëzit, sepse çështja e Kosovës nuk duhej të përzihet me çështjen e Shqipërisë. Aty përzihet çdo gjë, bëhet njëfarë forme që pastaj futi urrejtje në mes se kush është prej Shqipërie është tradhtarë, jo kush është prej Kosove e nuk vjen me neve është serb. Futnin urrejtje mes komunitetit, sidomos ajo kryesia e tyre që ishin, futnin një lloj urrejtje mes komunitetit. I kam parë pakënaqësitë, menjëherë jam takuar me disa prej të rinjve, shumica të cilët ishin më shumë studentë që kishin ardhur prej Kosove, njerëz të cilët kishin ardhur edhe kanë qenë aktiv edhe atje. Edhe e diskutonim mënyrën.. Për shembull nëse unë kisha dashur marksizëm-leninizëm kisha shkuar në Shqipëri, e jo në Amerikë. Me pasë dashtë atë lloj sistemi na e kemi pasur shumë afër Shqipërinë edhe arsyeja ka qenë ajo pse ka filluar shoqata “Shpresa”. Pikërisht ka qenë ajo ndasia.

Anna Di Lellio: Të gjithë Kosovarë?

Besim Malota: Jo, nuk kanë qenë të gjithë kosovarë. Kemi pasur prej të gjitha anëve, kanë qenë nga Malësia, Vuthaj, nga Dibra ka pas shumë. Dibran kanë qenë shumë që kanë marrë pjesë në shoqatën “Shpresa”, edhe kosovarë kanë qenë, por kanë qenë të gjithë ata që ishin jo të pajtimit që të jemi nën ndikimin e misionit shqiptarë, por ne duhet të jemi të lirë të veprojmë vetvetiu. Atë çka ne dimë çka janë kërkesat e Kosovës, por ne kishim ardhur pikërisht prej aty ku buronin kërkesat, dhe nuk kishim nevojë që të vinim këtu dhe t'i dëgjonim ata që as lidhje me Kosovë nuk kanë pasur edhe të na tregonin se çka duhet dhe çka do të thotë Republika e Kosovës ose si duhet vepruar ose në çfarë forme duhet vepruar. Pastaj ka filluar Liga Qytetare Shqiptare, ne kemi qenë krah i djathtë i Ligës Qytetare Shqiptare dhe e kemi përkrahur me shumicë Ligën Qytetare Shqiptare, derisa ajo ka marrë një hov pak më të madh.

Pastaj kanë filluar këto partitë politike të cilat i kanë shuar të gjitha shoqatat. Dhe ai ka qenë një gabim shumë i madh që është vepruar në Shtete të Bashkuara të Amerikës me themelimin e partive politike, sepse nuk mund të themelosh parti në një shtet tjetër. Partia në Kosovë, dega në Amerikë, ajo është diçka absurde, e papranueshme. E kemi diskutuar këtë rast, e kemi diskutuar edhe me të ndjerin doktor Ibrahim Rugovën, kemi qenë disa herë në takime me të. Ka qenë kundër themelimit të Ligës Demokratike të Kosovës.

Por Liga Demokratike e Kosovës në New York është themeluar nga doktor Ali Aliu. Edhe ai as që donte me dëgjuar, ne atëherë e kemi ditur që nuk ka ndonjë lloj interesi që të themelohet LDK në New York, por interesi ishte grumbullimi i fondeve, edhe atëherë i kemi thënë edhe Rugovës edhe Ali Aliut. Ne si komunitet po ja u premtojmë 300,000 dollarë në vit, dhe ja u dërgojmë 300,000 dollarë, por ama mos themeloni parti këtu sepse vetëm do ta përçani komunitetin. Në fillim ka qenë shumë aktive, kanë arritur, por ja sot ku janë? Të gjitha janë të shuara. I kanë shkatërruar shoqatat dhe më në fund edhe ata janë shkatërruar sepse vetë ata prej baze i kanë shkatërruar, se ata nuk kanë më interesin e tyre

këtu. Edhe nuk kanë nevojë që të kenë parti këtu, edhe nuk merren fare me ta. Ai ka qenë një gabim shumë i rende, shumë trashanik.

Anna Di Lellio: Çka ishte puna juaj atëherë?

Besim Malota: Unë atëherë kam qenë, kam punuar në NYU Hospital kam qenë *doorman* [roje]. Ma vonë *supervisor* [mbikqyrës] kam qenë në maintenance [mirëmbajtje] aty në atë kohë. Kur kemi ardhur këtu ishte e pamundur sepse të gjithë ne kemi ardhur përmes kanaleve të ndryshme, nga Meksika, do të thotë, kemi ardhur me borxhe. Nuk kemi ardhur me diçka, por kemi ardhur me borxhe. Dhe kemi qenë të detyruar të fillojmë punën, e pamundur që të vazhdojmë shkollimin për shkak të kushteve që nuk i kishim në atë kohë. Edhe komuniteti shqiptarë nuk kishte para, i organizuar që t'i ndihmonte të rinjtë kur erdhëm në atë kohë, që do të thotë që ta gjejmë një mënyrë se si t'u ndihmojmë atyre që po vinin prej atje të vazhdojnë se paku shkollimin këtu, nuk ka pas para, nuk ka pasur asnjë gjë, asnjë lloj aktiviteti në atë drejtim nuk ka pasë. Është dashur të punosh që ta krijosh ekzistencën tënde dhe të familjes.

Kështu që, tash është një situatë tjetër, një situatë më e mirë, megjithëse tash janë më të ngritur, më të vetëdijesuar njerëzit që janë këtu, tregon edhe nga vetë shkollimi i fëmijëve tonë që kanë ecur shumë më përpara. Kur kam ardhur unë këtu i kam gjetur shumë mbrapa. Me gjithë respektin, kanë punuar, kanë arritur të krijojnë pasuri, por nuk kanë arritur që t'i shkollojnë fëmijët e tyre. Për shumë prindër ka qenë më e arsyeshme që ta dërgon djalin në picë pas shkollës së mesme, sesa ta dërgon në një Univerzitet diku. Më e arsyeshme ka qenë nëse ai i ka sjellë 50 dollarë në shtëpi sesa ta dërgonte diku nëpër shkollime dhe ai ka qenë një gabim shumë i madh i emigracionit tonë këtu. Sepse kur kemi ardhur ne këtu në New York nuk ka pasur asnjë avokat shqiptarë. Asnjë nuk ka qenë kur kam ardhur unë.

Anna Di Lellio: Një?

Besim Malota: Jo asnjë. Zero. Sot janë mbi 60-70. Krejt kjo ka qenë ardhja e emigracionit të ri nga Kosova, të cilët vinin nga studimet, nga shkollat ata e kishin një lloj tjetër, ata e dinin se mund të bësh pasuri, por nëse nuk i ke shkolluar fëmijët, ti je askund, do mbetesh askund më vonë. Pasuria më e madhe është shkollimi i fëmijëve të tu, dhe ajo filloi dhe u ngrit shumë komuniteti.

Anna Di Lellio: Kam një pyetje. Sa edhe kur keni pasur ide për të ftuar delegacionin në Amerikë. Sa dhe kur?

Besim Malota: Po, ideja ka lindur menjëherë pas fillimit të Aksioneve në Kosovë, sepse e ceka edhe më parë ishte rasti kur njërin prej anëtarëve të kryesisë e kishim pikërisht ka qenë Gjergj Domgjonaj në hasmëri me familjen Shabanaj. Edhe çdo herë është dashur dikush të ndërhyj mes këtyre familjeve që të kenë besë. Ose është dashur që dikush të shkon ta merr Gjergjin në shtëpi edhe normal nëse ai është futur në makinën e ndokujt, askush nuk del ta vret sepse është në besën e atij njeriu që është me të. Ose është dashur ta dërgonim te shtëpia shpeshherë, ai edhe mungonte në aktivitete.

Kjo ka qenë arsyeja pse lindi ideja në shoqatë, pastaj u laborua dhe u parapa se sa do të kemi shpenzime, sa do të kemi, buxheti i shoqatës sa do të ishte. U nda një shumë e parave nga buxheti i shoqatës, në atë kohë kishte vetëm dy linja që udhëtonin për ish Jugosllavi, një ishte në Beograd ku shkonte Jati, dhe tjera ka qenë Panami shkonte në Zagreb. Biletat ishin ekstrem të shtrenjta, unë e di

në atë kohë kemi paguar për person diku nga 1600 dollarë çdo biletë. Sot janë shumë më lirë sesa kanë qenë atëherë sepse kishte vetëm dy linje që shkonin dhe çmimet ishin monopol në atë kohë sidomos të aeroplanëve. Njerëzit nuk udhëtonin aq shumë. Shoqata e ndau buxhetin e biletave, buxhetin e strehimit pastaj është dashur hoteli të parapaguhet sepse hoteli nuk pret derisa ti bashkon parat por duhesh ti parapaguash. Dy prej shoqate i kanë vënë kredit kartat e veta në hotel edhe kështu që është caktuar buxheti i hotelit dhe kanë qenë shpenzime shumë të mëdha. Dhe të gjitha ato janë rregulluar përpara dhe ka marrë dy muj ditë. Pastaj jemi konsultuar me grupin atje.

Anna Di Lellio: Me Anton Çettën?

Besim Malota: Atje është udhëhequr krejtësisht me akademik Mark Krasniqin. U caktuan ata se kush do të vie, kemi shkuar nga ajo forma që të jenë nga të gjitha territoret se jo vetëm nga një vend, për shkak se këtu është komuniteti shumë i përzier. Dhe kemi arritur që të kemi edhe nga Maqedonia, ka qenë profesor doktor Agim Vinca, i cili nuk është marrë me Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë fare, i vetmi Aksion i Pajtimeve të Gjaqeve ka qenë në Amerikë ku ai ka marrë pjesë, Agim Vinca. Tjerët kanë qenë pjesë e Pajtimeve pothuajse nga të gjitha anët, por Agim Vinca ka qenë vetëm në Shtete e Bashkuara të Amerikës ku ka marrë pjesë në Pajtimin e Gjaqeve. Ai edhe kur është kthyer atje nuk ka marrë, sepse ai e ka pranuar atë ftesë vetëm që ishte nga ana e Maqedonisë.

Edhe këtu kemi një komunitet shumë të madh të shqiptareve prej Maqedonie, apo profesor Tomë Berisha ka qenë i ndjeri prej, ka ardhur prej Zagrebi, ose Gjergj Gjokaj i cili erdhi nga Malësia, e ceka edhe më parë që Gjergj Gjokaj do të thotë ne nuk kemi ndërhyre në atë besëlidhjen që ka krijuar Gjergj Gjokaj. Ato familje që kanë qenë në atë lloj besëlidhje ne i kemi lënë dhe nuk i kemi prekur fare, sepse të gjithë thoshin që në Detroit janë mbi 200-300 familje, mirëpo kur erdhi profesori i nderuar Gjergj Gjokaj i ndjeri, ai në bazë të listave sepse i kishte të gjitha, tha, “Këto janë gjëra të kryer edhe nuk duhet më ndërhyrë në to sepse ata rrinë mbrapa kësaj besëlidhje dhe kjo është afatgjatë, nuk është vetëm një falje këtu por është afatgjatë. Nesër nëse i ndodh ndokujt prapë të njëjtit njerëz i shkojnë edhe i thonë, “A je në Besë të Malësisë?” Po ose jo, dy fjalë janë, nëse thotë po aty nuk ka do të thotë hakmarrje, e andej nuk kemi prekur fare. Ka qenë dy muaj përgatitje pastaj ata kanë ardhur, kanë qëndruar 30 ditë këtu, dhe pas 30 dite janë kthyer për Kosovë.

Pjesa e Dytë

Anna Di Lellio: A mund të flisni për rolin e grave në pajtimin e gjaqeve?

Besim Malota: Po, edhe këtu në New York, edhe në delegacion ka pasur gra që kanë ardhur prej Kosove, ka qenë e ndjera Nekibe Kelmendi bashkëshortja e Bajram Kelmendit pastaj në shoqata kanë qenë, edhe në organizim kanë qenë femrat, kanë qenë Hatixhe Nikçi, Zoja Ahmetaj. Kemi pasur raste ku fjala e Nekibe Kelmendit ka vlejtur me shumë se fjala e gjithë tjerëve, e cila u kërkonte sidomos në emër të nënave. Thoshte, “Ti si nënë, ngritu dhe fale”. Edhe kemi arritur, ka pasë edhe gjatë organizimit mjaft femra që janë bashkuar, në veçanti ka qenë edhe Shqipe Biba, ajo e cila ishte aktive në atë kohe, bashkë me neve vinte pothuajse në çdo vend, merrte pjesë me

neve në çdo vend. Roli i pajtimit është më shumë nga gjinia mashkullore të cilët e kanë udhëhequr, por realiteti është se kjo është filluar nga femra.

Është pikërisht Have Shala ajo që e ka filluar në Kosovë, dhe nuk është filluar nga Anton Çetta apo nga akademik Mark Krasniqi apo tjetri por është filluar pikërisht nga Have Shala, e një grup vajzash të reja që kanë qenë në atë kohë dhe kanë qenë ish të dënuara politike. Sepse Have Shala është e gjeneratës time edhe pothuajse në të njëjtën kohë ajo pak pas meje ka rënë në burg. Unë kam qenë i liruar kur ajo është arrestuar, por është e asaj gjenerate dhe e di që ka qenë për disa vjet e burgosur politike në Kosovë. Më vonë pasi është dalë nga burgu, si ta ndihmon popullin e vet prapë dhe e ka filluar Aksionin e Pajtimeve të Gjaqeve bashkë me shoqet e veta dhe disa djem të ri që ju kanë bashkuar. Kanë hasur në vështirësi menjëherë, nuk i kanë njohur format, nuk i kanë njohur zakonet, nuk i kanë njohur, nuk kanë pasur dijeni në ato.

Kanë shkuar dhe kanë kërkuar ndihme, në realitet kanë shkuar dhe kanë kërkuar ndihmën e akademik Mark Krasniqit, dhe ai i ka drejtuar te Anton Çetta. Do të thotë, Antoni është ai që i njeh këto më shumë se çdokush tjetër, edhe akademik Krasniqi gjithmonë më thoshte se Anton Çetta është marrë me këtë lëmi gjithmonë. Ka qenë një njeri i cili ka grumbulluar rreth kësaj, dhe i ka drejtuar aty, dhe ka bërë shumë mirë që i ka drejtuar aty sepse ajo pastaj mori përmasat e një lëvizjeje, lëvizje për pajtim e cila ka arritur një sukses shumë të madh, si në Kosovë edhe ashtu këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk jam në dijeni për Evropë, por për këtu e di që ka arritur një sukses shumë të madh.

Roli i femrës ka qenë shumë aktiv e sidomos në shoqatën “Shpresa” ka qenë gjithmonë aktiv, sepse në shoqatën “Shpresa” ka qenë gjithmonë një, në statusin e shoqatës ka qenë e paraparë që të jetë së paku një e treta e gjinisë femërore në udhëheqjen e shoqatës. Edhe gjithmonë në udhëheqjen e shoqatës ka qenë femra, ka qenë si në kryesi po ashtu edhe në këshill, se shoqata kishte edhe këshillin edhe kryesinë. Këshilli ishte ai i cili mbante në mes të dy kuvendeve të shoqatës.

Prej Pajtimit të Gjaqeve, prej grupit që ka qenë aty edhe shumë aktiv ka qenë Mulla Xhevati, Mulla Xhevat Kryeziu. Me Mulla Xhevatin njihemi qysh se para ardhjes së tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse jemi pothuajse prej të njëjtës zonë, prej të njëjtit vend. Unë jam nga Klina, ai është nga Bubaveci por ka qenë pjesë e Klinës në kohën kur unë kam qenë në Kosovë. Malisheva nuk ka qenë komunë, Klina ka qenë komune. Mulla Xhevatin e njoh qysh se atëherë, edhe kur ka ardhur këtu ka qenë mjaft aktiv. Ka arritur që të jetë në çdo vend, ishte me një vullnet shumë të madh për atë drejtim, që të luftohet ajo dukuri, që të hiqet, që të mos ketë më vëllavrasje, që të zhduket vëllavrasja.

Bile ai ka shkuar aq larg sa Anton Çetta ma tregonte një rast të tij, do të thotë, “Kur kemi shkuar në Bubavec në Pajtimin e Gjaqeve, në derë të Xhamisë e kishte shkruar, ‘T’i lëmë kishat, t’i lëmë xhamiat, feja e shqiptarit është Shqiptaria.’ Edhe Marku pastaj edhe Bajram Kelmendi dhe tjerët që kanë qenë pjesë e atij delegacioni që ka shkuar në Bubavec, e kanë thirrë e kanë pyetur, ‘Mulla Xhevat, a je ne vete, je në mend ti?’ Thotë, ‘Pse?’ Thonë, ‘Po qysh shkruhet në derë të xhamisë, t’i lëmë kishat t’i lëmë xhamiat feja e shqiptarit është Shqiptaria?’ Thotë, ‘Kjo është xhami, ti po ju thua njerëzve mos hyni në xhami’. “Por Mulla Xhevati është një kombëtarë, atdhetarë shumë i madh, mbi të gjitha ai e ka kombin e jo fenë edhe pse është predikues i fesë. Unë e respektoj mjaftë

për atë që është fetar dhe është predikues i fesë, por te ai kombi është mbi fenë. Kombi vjen para gjithë te ai.

Unë kam pasur disa herë biseda me të dhe e njoh kështu personalisht, kështu që kombi është parimor te ai dhe jo diçka tjetër. Pra edhe këtu ka qenë shumë aktiv, edhe këtu ka kërkuar prej të gjithëve. Pastaj ka qenë ajo koha kur akoma komuniteti jonë ishte pothuajse pak a shumë i ndarë. Këta kanë arritur, ky delegacion jo që i kanë pajtuar vetëm këto gjaqet e të vdekurve, por arriti edhe t'i pajton edhe të gjallët, sepse arriti të i heq ato dilemat jo ky është Enverist, jo ky është Ballist, jo ky është Titist. Ai arriti t'i thoshte të gjithëve që, "Ju të gjithë jeni shqiptarë, ne sot për sot armiq i kemi vetëm serbet dhe jo tjerët". Prandaj ju duhet me qenë të gjithë të bashkuar, lufta duhet me qenë kundër Beogradit dhe jo kundër njeri tjetrit këtu në komunitet.

Ai ka qenë sukcesi jonë më i madh që në realitet ky grup e ka arrit në Amerikë, pajtimin e të gjallëve, edhe shpesh herë është thënë që më shumë kemi nevojë ti pajtojmë të gjallët sesa të vdekurit. Se këtu në Amerikë kemi hasur më shumë probleme mes të gjallëve sesa ata që janë vrarë apo gjaqeve. Dhe ajo ka qenë një sukses i saj, sepse është arritur që pas largimit të tyre komuniteti ka qenë qind për qind më i bashkuar, duke i lënë anash ideologjitë partiake, duke i lënë anash ato. Komuniteti është bashkuar shumë më shumë. Më përpara kemi arritur për shembull, demonstratën më të madhe e kemi pas me 2000 vetë kurse pas pajtimeve që janë bërë këtu demonstratat, protestat që janë mbajtur kanë shkuar me 10.000-15.000 vetë.

Është ndërprerë vendi, do të thotë ajo ishte sukcesi që këta e bënë sepse këta gjatë gjithë kohës janë takuar edhe me grupet, me gjitha grupet këtu jo vetëm me, nuk janë marrë vetëm me pajtimin e gjaqeve, por janë marrë edhe me grupet tjera, për shembull, me llegalitetin, me Ballin Kombëtar, Blloku Independent është quajtur, Lidhja e Dytë e Prizrenit, me shoqatën "Shpresa", klubin kombëtar "Jusuf Gërvalla", që t'i bashkojnë të gjithë. Dhe gjithnjë ka qenë kërkesë e tyre që të gjithë duhet të jenë përkrahës të Klubit Shqiptarë, Ligës Shqiptare Amerika, sepse në atë kohë ishte DioGuardi i cili bënte një lobim shumë të madh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për çështjen e Kosovës dhe meritat e tij janë të pamohueshme. Meritat e DioGuardit janë shumë të mëdha në aspektin e njohjes së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kosova nuk është njohur fare në Amerikë. Në Washington as që është ditë ku ekziston, nuk po them në departamentin e shtetit, normal që e kanë ditur. Më kujtohet në 1987 kur është mbajtur takimi i parë në Washington, asnjë prej kongresmenëve nuk kishin ide se ku është Kosova, dhe çdonjëri prej tyre pyete, "A është në Rusi? A është këtu, a është aty." Kur ja shpjegonte që është në Jugosllavi, është mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, "Nuk kemi dëgjuar". Që u kërkonte mbështetje për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut, do të thotë ka qenë një, DioGuardi është ai që i ka hapur rrugët i pari çështjes së Kosovës në Washington. Më vonë ka edhe tjerë që kanë ndihmuar me shumicë, si kongresmen Eliot Engel, por ai i cili ka filluar është DioGuardi dhe lobimin që e ka bërë DioGuardi është diçka që ka qenë shumë e pabesueshme për një kohë aq të shkurtër çështja e Kosovës të kaloj aq lart në Washington, dhe të jetë pothuajse parimore në Washington.

Probleme si Kosova ka me mijëra nëpër botë, ka me mijëra probleme si Kosova dhe njerëzit as nuk e dinë ku ekzistojnë ato vende. Grupe sa ka popullsia Kosova nëpër botë, ka shumë. Shqiptarët në Amerikë në atë drejtim janë organizuar edhe përmes DioGuardit është arrit. Edhe këtu duhet të cek se meritën më të madhe e ka klubi kombëtar "Jusuf Gërvalla", sepse klubi kombëtar "Jusuf

Gërvalla” ka rënë në kontakt me DioGuardin përmes një anëtari të tyre, edhe ai anëtari i tyre u thotë se DioGuardi është shqiptarë. Ishte e pabesueshme një kongresmen të ishte shqiptarë dhe këta janë takuar me të, dhe kanë kërkuar prej tij dhe ai ka filluar që atëherë. Të parët njerëz të cilët e kanë ekspozuar DioGuardin në komunitet edhe e kanë përkrahur DioGuardin, kanë qenë të klubit kombëtar “Jusuf Gërvalla”, pastaj edhe tjerët e sidomos shoqata “Shpresa” ka qenë krahu i djathtë deri në vitet 1990, deri më themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pastaj ky ka pas prapë probleme përkrahëse.

Anna Di Lellio: Tash “Shpresa” nuk ekziston?

Besim Malota: “Shpresa” tash ekziston vetëm si emër dhe si korporatë, por jo nuk është aktive, edhe pse një grup i shokëve po përpiqen ta riaktivizojnë, por nuk e di, nuk është aktive. Kam biseduar me atë grupin të cilët po përpiqen ta riaktivizojnë, edhe është shumë keq që nuk është aktive, është shumë mangësi, sepse nuk ka asnjë shoqatë. Asnjë shoqatë nuk e kemi në New York. Na kemi shoqata lokale, jo shoqata “Rugova”, jo shoqata “Plavë e Guci”, por ato janë lokale dhe nuk janë aq të përgjithshme siç ka qenë “Shpresa”. “Shpresa” nuk ka qenë një shoqatë e kufizuar për një territor, por ka qenë shoqatë për të gjitha anët, edhe ka qenë shoqata edhe kulturore dhe politike, sepse ishte arsyeja se të gjithë në atë kohë merreshim me atë drejtim. Po së paku sikur do të kishte një shoqatë në New York e cila do të ishte një shoqatë kulturore, tash ma nuk më nevojë, sepse Kosova ka qeveri, ne nuk kemi nevojë të bëjmë punën e qeverisë. Nuk kemi nevojë që të shkojmë në Washington të merremi me çështjen e Kosovës sepse është ambasadorja jonë që merret me atë problem. Edhe Shqipëria ka ambasadë e saj që merret me atë problem. Kemi nevojë, po them për shqiptarët në Mal të Zi, për shqiptarët në Serbi apo Maqedoni, por jo për çështjen e Kosovës. Së paku të kishte një shoqatë që të ishte një shoqatë kulturore, që të promovojë kulturën.

Anna Di Lellio: Librat.

Besim Malota: Botimin e librave. Shoqata “Shpresa” në atë kohë ka pasur diku 10,000 libra bibliotekën.

Anna Di Lellio: Ku?

Besim Malota: Aty në shoqatë e kemi pas. Kemi pasur mbi 10,000 libra në bibliotekën e shoqatës. Unë thashë edhe më parë se shoqata “Shpresa” është themeluar prej një grup studentësh. Të gjithë njerëzit që kanë ikur nga Kosova për çështje politike. Edhe ata kanë qenë të gjithë njerëz që i kanë lënë shkollat atje dhe kanë qenë njerëz që lexojnë. Edhe kemi gjetur në Bruklin aty një vend ku një njeri i kishte gjithë ato libra të paketuara.

Anna Di Lellio: No!

Besim Malota: Të gjitha të paketuara dhe kemi shkuar dhe kemi arritur një marrëveshje me të dhe i kemi marrë të gjitha prej tij. Kanë qenë mbi 10,000 libra që i kemi marrë prej tij. Ai i ka sjell nga Shqipëria në realitet gjithë ato libra, por ka dashur me shpërnda librin, por nuk është marrë. I ka sjell i ka mbajtur aty dhe e ka pas një kompani aty, “Volurufin” është quajtur.

Anna Di Lellio: Në Floridë?

Besim Malota: Të gjitha i kishte aty të paketuara. Ishin të mbushura me pluhur. Unë jam drejtuar që ja kam kërkuar dhe i kam marrë të gjitha prej tyre. I kemi pasur në shoqatë, pastaj aty në shoqatë ato kanë qenë edhe duplikime të disa autorëve. Njerëzit i kanë marrë, i kanë blerë në realitet në shoqatë ato që ishin për t'u shit. Pasi nuk patëm më mundësi të vazhdojmë aty ku e kishim lokalën, se shoqata ka pasur lokalën e vet, janë dërguar shkollës shqipe në Staten Island. Janë falur shkollës shqipe në

Anna Di Lellio: Për bibliotekën.

Besim Malota: Të gjitha janë falë shkollës shqipe, përpos të mijat që kanë qenë personale, ato i kam në shtëpi, sepse unë i kam pasur edhe të mijat personale dhe i kam tërheq dhe i kam çuar në shtëpi timen. Dhe i kam edhe sot, vazhdojë që ti kem.

Anna Di Lellio: Diçka tjetër për pajtimet në Amerikë?

Besim Malota: Nuk e di çka të shtoj për pajtimet në Amerikë.

Anna Di Lellio: Më shumë rrëfime.

Besim Malota: Më shumë nuk e di çka kanë qenë.

Anna Di Lellio: Të rasteve.

Besim Malota: Ka qenë 30 ditorë, ka qenë mjaft i madh. Kanë edhe tjerët të flasin që kanë qenë aty pjesë. Përkrahje kemi pasur prej shumë njerëzve, përkrahje morale. Përkrahja morale dhe përkrahja materiale janë dy gjëra tjera [ndryshme]. Përkrahjen materiale nuk e kemi pasur nga njerëzit, por përkrahje morale po, çka ka qenë njerëz që janë bashkuar gjatë gjithë kohës. Na kanë ofruar ndihmë, jo ndokush me makinë me i dërguar deri aty, ose me bartje ose me këso, ose kanë qenë edhe prej këtyre pleqve të cilët kanë ardhur me neve në shumë vende. Ne i kemi marrë pak a shumë që kanë qenë më të vjetër, jo i njohin njerëzit, jo i njohin doket, jo i njohin zakonet se kush i ka tek i ka.

Kemi pas një rast në Bruklin aty, ai ka qenë rast i papritur për neve, sepse ne kishim shkuar në emër të popullit shqiptarë t'i kërkojmë falje. Ata janë nga ana e Alzhanicës në Mal të Zi atje, kur arritën të pajtohen njëri prej vëllezërve ngritët në këmbë dhe ia jep dorën Mark Krasniqit dhe i thotë, "Në emër timin dhe në emër të popullit mysliman e fali gjakun e vëllait." Askush nuk flet, djali xhaxhait të tij ngritët në këmbë edhe thotë, "Këtu tregon deri ku ka arritur armiku." Thotë, "Ky dy fjalë shqip nuk i din," thotë, "sepse aty ku është rritë nuk ka pasur të drejtë, edhe në shkollën ku ka shkuar i kanë thënë nuk je shqiptarë, por je mysliman." Thotë, "Që të tregon deri ku kemi arritur". Dhe ai ishte Shpend Haxha një figurë shumë e njohur në New York që kishte kushëri të parin atë që e falte gjakun.

I ndjeri Bajram Kelmendi u ngrit në këmbë filloi një recitim të lahutës së Malësisë. Të Atë Gjegi Fishtës. Aty përmendej gjyshi i atij që foli, atij që tha në emër të popullit mysliman. Në lahutën e Malësisë përmendej gjyshi i tij, dhe e recitoi atë pjesën e asaj lufte të Nukshiqit, ku gjyshi i tij ka qenë një ndër prijësit në luftë kundër Malazezëve edhe u ul. Kur u ul tha, "Kjo është mjerim. Kjo është falje, në rregull. Ai aq e ka, por ky e fali po kjo është mjerim në çfarë situatash është populli jonë, ku e ka sjellë armiku mu shuar. Në emër të popullit mysliman, ku ekziston populli mysliman,

ku ka popull mysliman. Shqiptarët mund të ndahen në mysliman, katolik e ortodoksë, shqiptarët shkojnë sipas grupit etnik dhe jo fetar. Shkojnë në formën e etnitetit si shqiptarë që janë dhe jo të asaj fetare”.

Ai ka qenë një rast kur kemi dalë prej aty të gjithë kemi qesh. Të gjithë kemi qesh, mirë që e fali në rregull, ai e fali edhe familja që u pajtua, edhe ata ishin shqiptarë, edhe ata flisnin shqip, edhe ky që e fali, por ai që e fali nuk fliste në shqip. Ai bile e tha në gjuhë serbe atë se ata i thonë në gjuhë myslimane, nuk ka gjuhë myslimane. Ka gjuhë serbe dhe ka gjuhë kroate, sepse nuk ka gjuhë malazeze nuk ka gjuhë myslimane. Ka dialekte po, por gjuhë jo. Ato janë pothuajse gjuhë sllave si ajo, si ajo. Në gjuhë myslimane? Nuk është gjuhë myslimane. Është gjuhë serbe, e tha në atë formë saqë kur dolëm jashtë ishim të gjithë duke qeshur. Po ne nuk i shkuam si mysliman ne aty me na fal ai neve. Po ai ishte në të mirë dhe ajo ishte e kalueshme.

Kemi pasur disa prej rasteve të llojllojshme. Kemi pas një rast që i ka fal tre në Bruklin. Tre djem i ka fal një në Bruklin, që ka qenë një familje. Ata kanë qenë nga Luma, nga ana e Shqipërisë andej. Nuk ka pas ndonjë vështirësi të madhe aty edhe pse nuk ishin të Kosovës, ne nuk i kemi caktuar se prej nga është. A është prej Malësie apo prej Kosove, vetëm a është Shqiptar. Qofshin nga Shqipëria, qofshin nga Kosova të gjithëve iu kemi shkuar, pa dallim se nga vjen. Pajtimi i Gjaqeve në New York nuk ishte i Kosovareve. Ka qenë i gjithë shqiptarëve në tërësi. Kemi pasur raste, për shembull nga Luma nga Shqipëria që kanë fal. Një rast tjetër ka qenë nga Peshkopia, ana e Dibrës apo Dibra e vogël siç i themi ne, që e kanë fal. Kemi pas disa raste Plavë e Guci atje. Raste nga Malësia e Madhe, nga Ulqini, pastaj raste nga Kosova dhe të gjitha këto janë si Shqiptarizëm i kemi shkuar të gjithëve. Dhe të gjithëve i është kërkuar në emër të popullit shqiptarë, pavarësisht a është prej Kosove a prej aty. Shikoni situatën ku jemi, dijeni se çka po na pret. Pse të jemi edhe në këtë lloj hasmërie, pse ta vazhdojmë këtë lloj hasmërie? Ka pas mjaft këso gjëra. Ka qenë 30 ditë, nuk mund të mbahet mend ajo.

Anna Di Lellio: Çdo ditë?

Besim Malota: Çdo ditë ka pas aktivitet.

Anna Di Lellio: Çka ishte më e vështirë?

Besim Malota: Po në realitet më të vështira ishin do raste që ishin shumë të lehta, që ishin ngatërresa pothuajse asgjë, më të vështira ishin ato sesa këto që ishin shumë të mëdha. Aty ku pritnim vështirësi shumë të mëdha, aty e kalonim shumë më lehtë, aty ku pritnim asgjë hiç, aty kalonim shumë më keq. Sepse aty nguronin njerëzit, “Jo, s’e fali. Jo, ma ka bërë kështu”, por nuk kemi ardhur me të pyet, ne nuk jemi gjyqtarë, edhe pse kishim shumë avokat me veti, sepse kanë qenë tre avokatë. Ka qenë i ndjeri Bajram Kelmendi, i ndjeri Adem Bajra dhe ka qenë Mustafë Radoniqi. Ai është edhe sot avokat Mustafë Radoniqi është në Pejë atje. Tre ishin avokatë, por ne u thoshim, “Nuk kemi ardhur me gjykua rastin këtu as me të pyet pse është bërë apo pse nuk është bërë.”

Kemi pasë një rast që ka qenë, ku e kanë prerë në fytyrë. Edhe ai thoshte, “E me ua falë unë ju, a më hiqen këto?” Kishte disa shenja në fytyrë ku e kishin prerë. Qysh i ka ra gjatë asaj ngatërrese edhe ai. Ka qenë një rast për një kohë shumë të gjatë edhe nuk pranonte në asnjë mënyrë. Njëri prej anëtareve të grupit tonë të “Shpresës”, Xhavit Kabashi e dëgjonte ai e kishte shok atë person. E

kishte shok edhe kishte kaluar një kohë mjaft të gjatë bashkë. E dëgjonte edhe hiç nuk i ndërhynte, dikur kur e pa që na lodhi me u marrë me atë njeri katër orë gjithë ai grup, u çua në këmbë Xhaviti dhe i shkon Anton Çettës afër i thotë, “Profesor,” dhe ai thotë, “Urdhëro Kabash!” “Zgjatma atë dorë,” ai ja jep dorën, “hallall të qoftë! Po kush p’e pyet këtë”. Njerëzit, “Ngadalë Xhaviti!” “Po kush po e pyet more këtë laper, katër orë ky laper, po ky nuk ka ndërgjegje. Po ky ka ikë prej Kosove, ka qenë i dënuar atje, ka ikë bashkë me mua. Kemi ardhur këtu. Ky në vend që me qenë i pari, ky na nxjerr telashe, ‘kush ma heq mua?’, po shko te mjeku bëje operacion. Pse a po ta paguajmë ne a? Paguaje vet, nëse ke pare paguaje vet, po nuk pate rri qashtu se boll mirë je. Ke grua, ke fëmijë. Hajt mos më shurdho!” Fillojnë të gjithë me qesh aty. Tha, “Punë e madhe ajo”. Dikur ai nuk kishte nga të ia mbante dhe u çua ia dha dorën, tha, “Po pasi ta fali ky nuk po kam çka me bë”. Tha le që ia fali, po tha “Thuaju aty që ky ka punë me mua, unë i kam borxh e jo ata. Të merret me mua”, i thotë. U çua edhe ai dhe ia dha dorën dhe tha, “Profesor, fal të qoftë”. Kemi pasë lloj rastesh.

Anna Di Lellio: *It was fun too.* [Ishte zbavitëse poashtu.]

Besim Malota: *It was, it really was.* [Ishte, vërtetë ishte.] Kemi njohur njerëz që nuk i kemi parë kurrë. Por e kemi një rast që nuk na e ka falë në New York. Është një rast që nuk është falë, dhe nuk na ka pranuar. Dhe ka qenë një veprimtar i dalluar edhe sot e mban veten shumë lart si veprimtar i çështjes kombëtare. Por as që na ka pranuar, edhe pse si ndërmjetësues e kam pasë dërguar disa herë Metë Bajraktarin që të bisedon me atë familje, sepse janë të lidhur kështu miqësisht. Ajo familje nuk e ka falë. Familja Osmani në New York, nuk kemi arritur marrëveshje. Ata kanë një vrasje këtu në New York dhe nuk është arrit fare marrëveshje me të. I kemi lënë anash për shkak se e pamë se e kotë, dhe nuk mund ta ndalnin grupin këtu edhe për 30 ditë tjera për një familje. Nuk donë me falë, nuk donë me falë. Por ishte e pa pritshme edhe për grupin se në atë kohë njëri prej anëtareve të familjes ishte shumë aktiv në Ligën Qytetare Shqiptare, ishte në kryesi dhe merrej me çështje kombëtare e me gjitha ato dhe nuk pritej prej tij me bë një gjë të tillë, “Duhet me më dhënë kohe”, “Po ku mundemi me të dhënë kohë na ty, neve na kushton këtu”. Ne donim t’i dërgonim për Kosovë andej edhe s’i kemi shkuar më kurrë, edhe është mbet ashtu në heshtje.

E vetmja familje ka qenë ajo e cila nuk e ka fal, ka qenë familja Osmani. Tjerët të gjithë, çdo rast që a e kanë treguar, sepse ne nuk e kemi pasë as idenë që janë të gjitha ato. E kemi pasur idenë diku për dhjetë raste, por jo për më shumë. Kur na kanë dalë, mos gabofsha 43 janë vetëm në New York. Plus në Detroit që janë bë disa pajtime, kur na kanë dalë të gjitha ato. Sepse si filloi ajo njerëzit vinin dhe na jepnin informacione, “Filani, filan familje, jetojnë Staten Island, jetojnë në Queens, jetojnë në Bruklin”. Pastaj është dashur të biesh në kontakt me ta, u dashke dikush ta merr përsipër, ai ka qenë më shumë obligim i imi.

Anna Di Lellio: Obligimi me familjet dhe punën?

Besim Malota: Me familjen e atij që duhej t’i shkoje te shtëpia. Është dashur t’i merrej telefoni, me i kontaktuar. “Kush je ti?” Kam pasë një rast kur kam qenë në restorant duke ngrënë darkë, ka kërkuar kush është Besimi, i kanë treguar, ka ardhur, “Më ka sha, si me më ra, me më ardhë te shtëpia të vras”. Ka pasë mjaft këso senesh, por ne nuk i merrnim parasysh sepse vullneti ishte më i madh që t’i pajtojmë sesa t’i kqyrësh se çka po thotë ai ose ky. Kemi pasë mjaft aso. 30 ditë ishin shumë të gjata në atë kohë. Rasti i fundit ka qenë, ishim duke ngrënë mëngjes, ata kishin me udhëtuar të hënën, ishte e diel kishin të hënën të udhëtonin për Kosovë të gjithë. Edhe tash gjatë

mëngjesit i përmbyllëm të gjitha ato. Ku kemi qenë, kush tek edhe atë proces-verbalin dhe e morën ata me vete në Kosovë proces-verbalin që është mbajtur në çdo pajtim: ku kemi shkuar, kush ka fol, çka ka fol? Ato i morën këta me vete, i kërkuan, i morën dhe ua dhamë.

Thotë, “Edhe një vend,” Anton Çetta thotë, “e kemi.” Ata thonë, “Ku, kush të thirri? Ne menduam që i kem krye, nuk kemi më të regjistruar ndokund.” “Jo,” tha, “e di unë.” “A profesor, ku donë me na çu?” U ngrit në këmbë tha, “Dojmë me shku,” te unë, “te Besimi”. Unë në atë kohë sa isha martuar, kisha më duket një vit martesë kështu. Edhe ai ngritet dhe thotë, “Ja do të shkojmë te Besimi, sepse edhe aty duhet me pajtu dikën.” Thashë, “Me kënd do me na pajtu?” Tha, “Me grua tënden,” tha, “30 ditë me ne poshtë e lartë, ajo ka të drejtë me të qit prej shtëpie.” Tha, “Shko edhe ti tash në Kosovë me ta!” Tha, “Jemi duke ardhur me te pajtu ty me shoqën tënde se edhe këtë punë duhësh me krye.” Thashë, “A mirë e ke,” thashë, “hajde sonte në darkë te unë.” Tha, “Ja, po patjetër”. Dhe ish ashtu, erdhën të gjithë për darkë aty te unë në mbrëmje, te shtëpia isha, kam jetuar në Queens atëherë. Edhe kam pasur familjen, ishin baba, vëllezërit, nëna jetonim të gjithë bashkë.

Kam pasë një shtëpi në Queens edhe erdhën aty për darkë, edhe kur hyri brenda ai shoqes time i thotë, “Hanë ty kam ardhur me të pajtu me burrë se nesër kam me shku për Kosovë, kështu që të ju pajtoj edhe ju dyve.” Ajo thotë, “Po ne nuk kemi diçka.” Thotë, “Eh, 30 ditë, çka di unë çka ke m’i thënë ti pasi të shkojmë ne? I thua rrugaç, ke dalë rrugëve, ke shkuar poshtë e përjetë, më ke lënë vetëm”. Megjithëse, ajo vinte shpesh. Në disa raste ka ardhur, jo në pajtime kështu, por ka ardhur në darka, në takime, kur kemi udhëtuar për Boston atje ka ardhur. E njihnin ata të gjithë delegacioni shoqën, sepse e kishin takuar disa herë, në disa raste edhe e shoqëronte shpesh Nekibën, Nekibe Kelmendin, vinte shoqja ime. Pastaj kanë qenë ato dyja që ishin në kryesi të shoqatës, ato vinin pothuajse çdo ditë, Zoje Ahmetaj, dhe më fal Nushe Ahmetaj, dhe ka qenë Hatixhe Nikçi, ato vinin çdo ditë pothuajse në takim me Nekiben, në vende të ndryshme kishin me shku ato. Nuk di çka të them më për këtë ka qenë shumë e gjatë.

Anna Di Lellio: Shumë mirë.